

Prof. dr. Izber HOTI

MBROJTJA E KUFIJVE NË ANËN E GALLAPIT

(Diakroni përgjithësuese)

Që nga antika e deri më sot çështja e kufijve ndërmjet shteteve dhe organizmave të ishte dhe mbeti e pakapërcyeshme. Kështu ndodhi edhe të parëve dhe vetë shqiptarëve dhe në këtë mënyrë çështja e kufijve, veçanërisht mbrojtja e tyre, mbeti çështje mbi çështje. Në të vërtetë ruajtja e kufijve nga shqiptarët ishte një dukuri që përsëritej historikisht, duke iu vu përball pushtuesve që ishin përtej deti dhe kontinenti. Kjo mbrojtje filloi me kundërvënies ndaj sulmeve greke dhe romake dhe përfundoi me sulmet e sllavëve të jugut (serbë, malaziasve dhe maqedonasve). Pra, as Deti Adriatik dhe grykat dhe detet e tjera e masivet të thuash të pakapërcyeshme të maleve nuk u bënë pengesë e pushtuesve të ndryshëm që gjatë e shkurtë dhe shpeshherë cenuan e dhunuan kufijtë e ilirëve, përkatësisht dardanëve, madje edhe galabrojve që shtriheshin në këto e përtej këtyre kufijve artificialë deri në afërsi të Beogradit të sotshëm, gjegjësisht deri te Pllana. Që atëherë të parët e tyre dhe shqiptarët për fatin e tyre të keq nuk luftuan kurrë për zgjerim territorial dhe vendosjen e kufijve sipas dëshirës së tyre, por për mbrojtjen dhe të territorit ku ata gjithëherë ishin në shumicë absolute. Këtyre vendësve nuk i ndihmuan shumë as trimëria e tyre e pamohueshme dhe lufta e pareshtur as dhe as konfigurimi dhe pozita gjeografike, që të mos thuhet gjeostrategjike dhe as përbërja kryesisht e një etnie gjatë shekujve. Fati i këtyre anasve ishte përballja e tyre me fuqi më të mëdha për nga forca ushtarake dhe numri i popullsisë, siç ishin romakët, grekët e vjetër, bullgarët dhe sllavët, osmanët (turqit), më vonë edhe austro-hungarezët, si dhe gjermanët dhe italianët.

Në të gjitha rastet kur pushtuesit të sendërtonin planet dhe synimet e tyre në territoret e të parëve tanë vepronin dhe organizonin administrimin dhe ndarjet territoriale sipas qejfit dhe interesave të tyre. Kështu ndodhi edhe ndarjen e Perandorisë Romake në shekullin IV (395) në Perandorinë e Lindjes, e cila siç dihet nuk ishte vetëm ndarje e hapësirës dhe ndarje administrative, por edhe ndarje shpirtërore me pasoja kolosale dhe botërore, që, kuptohet, ndikuan para së gjithash te vendësit, përkatësisht te të parët tanë. Si pasojë e kësaj ndarjeje dhe brenda përbrenda një etnie dhe

një populli u krijuan kufij, ndoshta edhe me pasoja edhe më të mëdha, siç ishin ato të temave dhe principatave të llojlojshme që krijuan përçarje dhe luftëra të përgjakshme e shumëvjeçare. Mirëpo, po krimi i kufijve që nga antika deri më sot ndikonte edhe në ruajtjen e identitetit dhe të pavarësisë së një etnie dhe të një etnikumi, që do të thotë edhe të synimeve dhe të qëllimeve të tyre. Për këtë arsye ruajtja e kufijve pa marrë parasysh a u krijuan nga të huajt apo edhe nga të parët e shqiptarëve dhe të shqiptarëve ishte me rëndësi të madhe. Si pasojë mbrojtja e kufijve krijoi një histori të pasur jo vetëm të shqiptarët, por edhe të të gjithë popujt që luftonin për identitetin dhe pavarësinë e lirinë e tij.

Mbrojtja e kufijve tek ilirët dhe shqiptarët ka një histori të gjatë dhe dallonte nga koha në kohë, por edhe mbështetur në pushtuesit që ia mësynin territorit të shqiptarëve dhe të parëve tyre. Ajo bëhej drejtpërdrejt dhe tërthorazi sa herë-herë për shkak se kërcënimi i një shteti apo perandorie që mund të ishte edhe armike e shqiptarëve nënkuptonte edhe mbrojtjen e lirisë dhe të territorit të vetë shqiptarëve, siç ishte rasti i Perandorisë në fund të sundimit të saj, pastaj Perandorisë Bizantine dhe asaj Osmane (turke). Në këtë frymë madje edhe pjesëmarrja e shqiptarëve në Luftën e Krimesë (1856), mund të konsiderohej mbrojtje kufijsh nëse merret parasysh fjala e urtë popullore se shumë më e mirë është preventiva se sa shërimi. E kësaj natyre mund të shikohet edhe lufta e shqiptarëve në mbrojtjen e Kroacisë në fund të shekullit XX. Ç' është edhe më interesant në mbrojtjen e identitetit dhe të lirisë së tyre shqiptarët herë-herë u detyruan t'i shkatërronin kufijtë artificialë shqiptaro-shqiptarë, siç ishte p.sh. kufirin në mes të Shqipërisë administrative të formuar më 1913. Prandaj shqiptarët nuk luftuan vetëm për mbrojtjen e kufijve, por edhe për shkatërrimin e tyre.

*Mbrojtja e kufijve në kohën e luftërave ballkanike
dhe Luftës së Parë Botërore*

Lufta në kufij dhe lëvizjet rreth kufijve kishin edhe veçori të tjera. Ato zhvilloheshin varësisht nga rrjedhat e luftërave dhe karakteri i kundërvënies ndaj këtyre luftërave dhe i politikave që udhëhiqeshin nga pushtuesit dhe mbrojtësit. Sa për ilustrim do të ndalem në vija të përgjithshme në luftërat mbrojtëse të shqiptarëve të Prishtinës me rrethinën të ngushtë të saj më 1912, 1918 dhe 1944, që në fakt paraqet territorialisht anën e Gallapit.

Përleshjet e para të palëve ndërluftuese serbe- turke, përkatësisht shqiptare (sado që këta nuk iu përgjigjen mobilizimit në masë të duhur), më 1912 filluan që herët në rajonet kufitare. Më 2. X. 1912 (sipas kalendarit të vjetër, ndërsa më 17 tetor sipas kalendarit të ri) në sektorin kufitar të Prishtinës, i cili shtrihej përgjatë vijës Mavriq – Merdar – Prapashticë

– Medvegje, u zhvillua përlëshja e parë. Me këtë rast ushtria serbe dhe çetnikët goditën karakollët kufitare. Më 3 tetor, Divizioni i Prishtinës i drejtohet Podujevës dhe në të njëjtën natë filloi lufta në kufi me Serbinë. Të nesërmen një divizion i ushtrisë serbe filloi sulmin. Pas rrethimit të karakollit Shahinovci nga ana e ushtrisë dhe e çetnikëve serbë ndërpritën marrëdhëniet diplomatike në mes të Perandorisë Turke dhe Serbisë.¹

Pas shpalljes së luftës Armata e III Serbe kaloi kufirin më 7 dhe më 8. X. 1912 u nda në dy grupe të mëdha: djathtas sulmonte Divizioni i Shumadisë – thirrja e parë dhe Divizioni i Moravës – thirrja e dytë, ndërsa majtas Divizioni i Drinës – thirrja e dytë dhe Brigada e Moravës. Divizioni i Shumadisë hasi në kundërvënien e shqiptarëve në Podujevë. Pas një kohe të shkurtër më 20. X. 1912 ra Podujeva. Divizioni vazhdoi rrugën në drejtim të Tenezhdollit. Në rrugë e sipër sërish u sulmua nga shqiptarët (20 tetor), por ata u thyen së shpejti. Në grykën e Tenezhdollit një numër i konsiderueshëm shqiptarësh organizuan kundërvënie serioze, por pas veprimit të artilerisë serbe dhe ardhjes në ndihmë të Divizionit të Moravës u detyruan të tërhiqeshin. Pas këtyre luftimeve ushtria serbe vazhdoi marshimin e vet në drejtim të Prishtinës, ndërsa sipas të dhënave të kohës nga “fshatrat llapiane të kallura ngrihej tym i dendur”. Më 21 tetor të tri divizionet e ushtrisë serbe arritën në afërsi të Prishtinës. Divizioni i Drinës më 9 tetor u gjend në Butovc, në lindje të Prishtinës, Divizioni i Moravës luftonte me ushtrinë turke dhe me shqiptarët, të cilët ishin përqendruar në pozicionet luftarake para Prishtinës në vijën Dragodan – Mramuer – Gazimestan. Për të mbrojtur Prishtinën luftonte njësia ushtarake turke në Prishtinë, e cila ishte pjesë e Korpusit VII Turk, që në kuadër të saj kishte 14 batalione, 2 eskadronë dhe një divizion të artilerisë fushore. Pas një lufte të shkurtër Divizioni i Moravës, i ndihmuar nga Divizioni i Drinës, më 22. X. 1912, hyri në Prishtinë, kurse ushtria turke u tërhoq në drejtim të Kaçanikut. Po në të njëjtën ditë pjesët e tjera të Divizionit të Drinës, të plotësuara nga një pjesë e këmbësorisë u përqendrua në Prishtinë me qëllim të vendosjes së pushtetit dhe të çarmatosjes së shqiptarëve.²

Ndaj viseve të pushtuara forcat serbe sillehin si pushtuesit më të egër. Në të vërtetë, krahas pushtimit bëhej edhe çarmatosja e shqiptarëve, ndërsa me qëllim frikësimi trupat ushtarake serbe përdorën tortura të llojllojshme e madje shkatërruan fshatra të tëra të kësaj rrethine. Kështu, shumë krerë shqiptarë u detyruan të iknin në Shqipëri, ndërsa me mija familje iknin të lemerisura nga krimet e ushtrisë serbe. Më se 20 familje të fshatit Graçanicë ikën në Drenicë dhe kurrë nuk u kthyen më. Prej 120 shtëpive shqiptare në Hajvali, ushtrinë serbe e pritën vetëm 1/3 apo 3.040 shtëpi. E njëjta gjë

¹ Zeki (Paša), *Moje uspomene iz Balkanskog rata 1912. godine*, Beograd, 1925, f. 4

² Ružica Guzina, *Opština u Srbiji 1839 – 1918*, Beograd, 1976, f. 439.

ndodhi në fshatin Butovc. Pra, filloi një valë e re shpërnguljesh, e cila do të zgjasë deri në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore³.

Premtimet e shkelura me ripushtim

Me gjithë premtimet e dhëna me anë të proklamatës së 27. IX. 1918, me rastin e pushtimit të Prishtinës dhe të rrethinës ushtria nuk pati qëndrim të mirë ndaj shqiptarëve. Kështu në Prishtinë u pushkatuan me dhjetëra banorë të pafajshëm, ndërsa nuk kaluan më mirë as shqiptarët e fshatrave përreth.⁴

Qetësia e popullsisë së shqiptarëve ndaj vendosjes së pushtetit serb ishte e përkohshme. Kjo shihet nga qëndresa e ndjeshme në gjysmën e dytë të muajit tetor të vitit 1918. Në këtë kohë në veri të Prishtinës aty-këtu nëpër rrugë u vranë shumë ushtarë, të cilët nuk ishin nëpër grupe të mëdha, ndërsa më 25 tetor qëndrimi kundër serb mori përmasa të mëdha. Shkas për këtë ishte urdhri i naçellnikut të Stacionit Ushtarak të Prishtinës që të grumbullohej mbarë pasuria shtetërore e braktisur nga bullgarët e ikur. Shqiptarët dhe turqit nuk i bindeshin urdhrin dhe me forcë i larguan organet e pushtetit serb të komunës, prej të cilëve pritej të zbatonin urdhrin e naçellnikut. Për të qetësuar situatën naçellniku i Stacionit Ushtarak të Prishtinës luti komandantin e Regjimentit t'i çarmatosë shqiptarët dhe turqit e qarkut dhe kështu t'i rikthehej pushteti, ndërsa vetë qyteti të kontrollohej. Komandanti i Divizionit Jugosllav urdhëroi menjëherë komandantin e Regjimentit të 22-të Ushtarak të Prishtinës që në marrëveshje me pushtetin policor të "ruajë autoritetin tonë dhe nëse nevojitet të përdorën edhe armët". Pra, Shtabi i Divizionit Jugosllav situatën e krijuar e cilësoi mjaft serioze dhe kërkoi të raportohej për situatën nga dy herë në ditë. Mbështetur në raportet e kohës shihet se gjatë këtij muaji punohej me të madhe në vendosjen e pushtetit serb, për aftësimin e hekurudhave, si dhe në çarmatosjen e popullsisë shqiptare.⁵

Për të çarmatosur popullsinë shqiptare u organizuan çeta të ndryshme, të cilat u nisën nga Prishtina. Si pasojë, një mori fshatarësh të kësaj rrethine iu nënshtruan këtyre veprimeve e çarmatosjes. Të tilla veprime u shquan në Hamidi, Shipitullë, Kobiliq të Epërm dhe në Kobiliq të Poshtëm. Çarmatimit iu nënshtruan edhe fshatrat të tjera të rrethit të atëhershëm të Graçanicës, të cilat shtriheshin në të majtë të Sitnicës. Si kundërpeshë shqiptarët e fshatit Bivolak në nëntor të vitit 1918 i sollën pushtetit

³ Po aty.

⁴ Shënime të mbledhura në terren.

⁵ Bogumil Hrabak, *Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države s arbanškom većinom stanovništva u jesen 1918. godine i držanje arbanasa prema uspostavljenju vlasti*, Gjurmime albanologjike, nr. 1, Prishtinë, 1969.

vështirësi të mëdha. Më 18 nëntor 1918 Feriz Klinaku me 36 pasuesit e tij sulmoi komunën e Crkvenavodicës. Përleshja e rreptë zgjati më se dy orë. Pas kësaj përleshjeje kundër Hadës dhe Bivolakut u organizuan ekspedita ndëshkimore ushtarake të shoqëruara edhe me armë artilerike. Popullsia e paorganizuar nuk iu kundërvu veprimeve ushtarake, ndërsa në anën tjetër te popullsia nuk u gjetën kurrfarë armësh. Luftime sporadike zhvilluan vetëm disa grupe të tubuara rreth ndonjë udhëheqësi të tyre. Udhëheqësit dhe njerëzit e tjerë të këtyre fshatrave ikën, kurse disa sish u burgosën nga ana e organeve shtetërore. Megjithatë, pushteti ushtarak dhe policor gjatë tërë vitit ishte në gjendje gatishmërie. Nga Prishtina drejtoheshin grupe të ndryshme që qetësonin popullsinë shqiptare, e cila dita-ditës vinte duke u organizuar edhe politikisht kundër vendosjes së pushtetit serb në këtë trevë.⁶

Ripushtimi në Luftën e Dytë Botërore Situata do të ndryshojë shumë me rastin e ripushtimit të kësaj ane më 1944. Në këtë kohë forcat ushtarake gjermane filluan të shtohen dukshëm, siç ndodhte edhe me forcat ushtarake shqiptarëve.

Në gjysmën e muajit janar të vitit 1944 në Prishtinë ishte një regjiment gjerman prej 3.000 vetash, të ndarë në tre batalione dhe në një çetë mitraljere me dy bateri (e para 65/17 dhe e dyta 75/13). Kjo forcë ushtarake, përveç të tjerash, kishte për detyrë që në rast të hapjes së Frontit të Dytë në Lindje të siguronte hekurudhën Prishtinë – Kralejë dhe Prishtinë – Shkup.⁷ Në shkurt të vitit 1944 në këto anë ishte i përqendruar edhe Regjimenti IV i Ushtrisë Shqiptare. Ky regjiment, sikurse edhe regjimentet e këtilla në Kosovë, kishte tre batalione dhe një bateri malore. Secili batalion kishte nga tri çeta, të shenjëtarisë, nga një çetë mitraljerë, që ishte e pajisur edhe me armë të rënda dhe një çetë komande, që përcillte batalionin. Po kështu, secila çetë kishte nga tri togje të shenjëtarisë dhe një togë mitraliere. Secili batalion kishte nga 750-800 njerëz. Komandant i Regjimentit IV në Prishtinë ishte Fuat Asllani.⁸ Pos këtyre forcave në këtë anë u vendosën edhe trupat për furnizim të Divizionit XXI SS “Skenderbeu”, kurse më 1. IX. 1944 në territorin e Prishtinës gjendej i tërë Divizioni XXI SS “Skenderbeu”.⁹

Mirëpo, forca të shumta shqiptare e gjermane në Prishtinë dhe në rrethinë u përqendruan në muajin shtator i vitit 1944. Kjo u bë me qëllim të sigurimit të tërheqjes së grupeve të Armatës “E” nga Greqia dhe të forcave të tjera gjermane, por edhe të mbrojtjes nga depërtimi i forcave partizane. Duke u tërhequr nga Greqia gjatë këtyre ditëve në Prishtinë gjendeshin 6

6 Po aty.

7 *Zbornik, 1 19*, dok. nr. 87 dhe *Zbornik, XII* dok. nr. 14.

8 *Zbornik, 1 19*, dok. nr. 98.

9 *Nemačke snage na teritoriji Jugoslavije u toku NOR-a. Vojno istorijski glasnik*, nr. 1, Beograd, 1953, f. 92.

divizione gjermane,¹⁰ kurse për të siguruar tërheqjen e tyre p. sh. më 6 e 7 shtator 1944 në relacionin Prishtinë – Podujevë qarkullonin 7-8 kamionë me afër 200 ushtarë.¹¹

Nuk vonoi shumë dhe në tetor të vitit 1944, pas riorganizimit të Divizionit SS “Skënderbeu” me iniciativën e Udhëheqjes së Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe pas fillimit të tërheqjes së trupave gjermane nga Greqia dhe viset e tjera, Prishtina u bë qendër e përkohshme ose vetëm vendkalim i grupeve të ushtrisë të gjeneralit Sholc, të Shtabit Pranues të Divizionit XXI SS “Skënderbeu”, e lidhjeve me Divizionin “Princ Eugen”, e tubimit të Grupit Luftues “Langer”, e tubimit të Batalionit të 212-të Tankist, e Batalionit III Policor, e Batalionit të 609-të të Divizionit Artilerik të Marinës, e Regjimentit të 65-të, e Divizionit të 22-të të këmbëorisë, e Divizionit të 11-të të Këmbëorisë Ajrore, e Divizionit të 13-të, e Divizionit 714-të, e Regjimentit të 724-të Gjuajtës etj.¹² Këto dhe formacionet e tjera ushtarake gjermane duhej të tërhiqeshin sa më shpejt nga këto territore. Për këtë u vu në veprim i mbarë potenciali ushtarak e teknik, kurse aeroporti i Obiliqit duhej të bëhej aeroport komandues.¹³

Edhe pse këto forca ishin vetëm në kalim apo siguronin tërheqjen e grupeve të Armatës “E” dhe të njësiteve të tjera, ato u bënë kundërpeshë e madhe e njësiteve të UNÇJ-së, që filluan operacionet për ripushtimin e Kosovës. Mirëpo, kundërpeshë e konsiderueshme e UNC-s ë u bënë edhe forcat armatosura shqiptare. Ato filluan të shtoheshin që nga formimi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, e cila krahas propagandës u angazhua edhe në organizimin e forcave ushtarake. Edhe për këto forca Prishtina u bë njëra ndër qendrat e rëndësishme. Komanda e Përgjithshme e Rinisë për Mbrojtjen e Kosovës, që e kishte qendrën në Prishtinë, arriti që në këtë kohë që të tubonte me mijëra vullnetarë e të t'i përqendronte në kufi për të penguar depërtimin e njësiteve të UNÇJ-së dhe njësiteve të tjera ushtarake të aleatëve të UNÇJ-së.

Përlshjet e grupeve ndërluftuese u paraprinë nga një varg përlshjesh. Në të vërtetë forcat e Divizionit 21 SS “Skënderbeu” qysh në fund të muajit qershor të vitit 1944 u përlshën me forcat e UNÇJ-së, por edhe me forcat të tjera në kufi. Në këto përlshje humbjet ishin të konsiderueshme nga të dy palët.¹⁴ Përlshjet midis këtyre dy forcave në kufi vijuan edhe gjatë tërë muajit korrik të vitit 1944.¹⁵ Në muajin gusht të këtij viti përlshjet në

10 Zbornik, I/11, f. 471-475.

11 Zbornik, I/11, f. 227, 322, 351, 354 dhe 471.

12 Zbornik, XII/1, shtesa 2, 146, 151, 159, 222 (f. 1169-1178); Zbornik, XII/4, dok. nr. 162; Antun Miletić, *Kosovo iz aspekta okupacione uprave Vermahta u Srbiji (1941-1944)*, Kosova — Kosovo, nr. 4, Prishtinë, 1975.

13 Zbornik, XII/4, shtesa nr. 2.

14 Zbornik, XII/4, dok. nr. 84; *Lidhja e Prizrenit*, nr. 17, 9, VIL 1944

15 AQSH i RPSSH, fondi 810, dos. 33, viti 1944, dok nr. 1.

kufi u shpeshuan. Në kufirin e gjatë më se 20 km në pikat Zhujë, Kitkë, Velegllavë, Çukë e Zezë, Koblak etj., në këtë kohë ishin përqendruar forca të mëdha ushtarake shqiptare dhe gjermane (3.000-3.500), që nuk kalonte ditë pa u përleshur me forcat e UNÇJ-së në këtë anë. Humbjet e të dy palëve ndërluftuese gjatë muajit gusht ishin me qindra të vrarë e të plagosur. Luftimet e muajit gusht të vitit 1944 në rrethin e Prishtinës u shoqëruan edhe nga sulmet e rralla të aviacionit aleat. Kështu, natën e 21/22. VII. 1944, pas fluturimeve të ulëta të këtij aviacionit, u bombardua Fushë Kosova, mirëpo kjo nyje komunikacioni nuk pësoi shumë dhe humbjet nuk ishin të mëdha.¹⁶

Muaji shtator i vitit 1944, përveç përleshjeve të kohëpaskohshme në kufi, u shqua edhe me konsolidimin e forcave të të dy palëve ndërluftuese. Në këtë muaj u formua Korpusi XIII i UNÇJ-së prej 4 divizioneve (i 22-të, i 24-të dhe i 47-të), kurse forcat kundërshtarë punonin edhe më tej ë konsolidimin e forcave të veta, që vrojtoheshin me kujdes nga forcat e UNÇJ-së.¹⁷

Fronti i Prapashticës

Përleshjet e njësiteve të UNÇJ-së me forcat ushtarake gjermane dhe me formacionet ushtarake të Lidhjes së Dytë të Prizrenit vijuan edhe në gjysmën e parë të muajit tetor të vitit 1944. Përleshje të tilla pati gjatë gjithë kufirit prej Merdarit deri në Kitkë, por u dalluan luftërat në "Frontin e Prapashticës", në të cilat humbjet e të dy palëve ishin të konsiderueshme.¹⁸ Në, sajë të situatës politike e ushtarake dhe të mbështetura në urdhrat e Shtabit Kryesor të UNÇJ-së dhe të Shtabit Kryesor të dhe të AP të Serbisë, që nga 15 e deri më 22 të muajit tetor, njësitet e UNÇJ-së, në bashkëveprim me Armatën II Bullgare arritën në vijën Orllan – Brainë, Lisicë – Hajkobillë.¹⁹ Me këtë filloi sendërtimi i planit për ripushtimin e Kosovës, pra edhe i rrethit të Prishtinës.

Fillimi i operacioneve në drejtim të Kosovës u caktua më 23 tetor të vitit 1944. Në këtë kohë Divizioni XII Bullgar, që vepronte në drejtimin Tullar – Prishtinë u shty nga pozitat e mëparshme Gurishtë — Lisicë — Mutivodë. Për këtë arsye, më 25 tetor 1944, u parapra sulmi i përgjithshëm i forcave bullgare në drejtim të Prishtinës, ndërsa Brigada V me "Batalionin Shqiptar të UNÇ-së" (kështu quhej shpesh Batalioni "Meto Bajraktari") të bashkëvepronte me forcat bullgare dhe të sulmonte Kalaticën, Batllavën dhe Orllanin, ku ishin të dislokuara forcat gjermane. Prej 25 tetorit deri më 28 tetor 1944, njësitet e Divizionit XII Bullgar, pas luftërave të rrepta,

¹⁶ *Zbornik. XII/4*, dok. nr. 96.

¹⁷ AIUH, reg. nr. 1-5 5. k. 1342; *Zbornik-1* 11, f. 394 dhe f. 363.

¹⁸ *Mitrovica dhe rrethina*, Mitrovicë, 1979, f. 420; Nikola Vidačić, *Na obalama Nerodinke*, Novi Sad, 1958, f. 219; *Lidhja e Prizrenit*, nr. 32, 22. X. 1944.

¹⁹ *Zbornik. I 14*, dok. nr. 180 dhe dok. nr. 199.

arritën të marrin vijën Zaprozhan – Nishevc – Gurishtë – Mutivodë, kurse Brigada V NÇ e Kosovës dhe Metohisë në bashkëveprim me njësitet e Divizionit XII Bullgar morën vijën Kodra e Ujqve — Kalaticë. Edhe pas këtij suksesi luftimet vijuan. Më 28 tetor 1944 njësitet bullgare arritën të dilnin në vijën Nishevc – Mutivodë. Tri ditë më vonë (më 31 tetor) njësitet e Armatës II Bullgare, duke luftuar në drejtimin Prishtinë, e shtyn forcat mbrojtëse në drejtim të Prishtinës.²⁰ Po në këtë kohë Brigada V NÇ e Kosovës dhe Metohisë në bashkëveprim me njësitet bullgare zhvilluan luftëra të repta në Orllan e Brainë. Në Çukë të Drazhës kjo Brigadë, pas një lufte të rreptë me gjermanët, arriti të lidhej me Brigadën XVII të Divizionit XXIV të UNÇJ-së.²¹ Kjo shtoi edhe më shumë mundësitë e luftës në këtë anë.

Në fillim të muajit nëntor të vitit 1944 sulmet e UNÇJ-së shtoheshin çdo çast, kurse sukseset nuk mungonin.²² Forcat e UNÇJ-së më 3 nëntor arritën të depërtonin thellë në jug të fshatit Orllan. Si pasojë shqiptarëve dhe gjermanëve i nevojitej shtimi dhe konsolidimi i mëtejshëm i forcave të veta të armatosura. Kjo nuk pengonte formacionet e UNÇJ-së në verilindje të Prishtinës për realizimin e qëllimeve të parapara në planin që zbatohet gjatë 4 - 12. XI. 1944.²³ Në anën tjetër forcat e armatosura të UNÇJ-së me sukses depërtonin në drejtim të Prishtinës nga Bujanovci në Gjilan,²⁴ kurse sulmet e UNÇJ-së në rrethin e Prishtinës në këtë kohë u ndihmuan mjaft edhe nga veprimtaria e aviacionit aleat. Me rastin e sulmit të serishëm të këtij aviacioni në Fushë Kosovë u paafësua një kompozicion treni me armë, por edhe humbjet në njerëz (veçanërisht të Divizionit 21 SS “Skënderbeu”) ishin të mëdha.²⁵ Përkundër, Armata e Dytë Bullgare dhe njësitet e tjera bullgare gjatë veprimeve luftarake mëdysheshin si në sektorin Lebanë – Prishtinë, ashtu edhe në Sektorin Gjilan – Prishtinë. Për këtë, por edhe për shkak të rezistencës së fortë të ushtrisë gjermane e shqiptare, operacionet luftarake të UNÇJ-së nuk, mund të zhvilloheshin ashtu siç ishte planifikuar. Vetëm pas urdhrit të prerë të oficerëve rusë që ta pushtonin këtë rreth gjatë 3 ditësh Armata e Dytë Bullgare dhe njësitet e tjera bullgare u aktivizuan deri-diku.²⁶ Kjo bëri të mundur që më 16 nëntor 1944 njësitet e UNÇJ-së në bashkëveprim me Armatën e Dytë Bullgare të drejtohen në Prishtinë dhe në rrethinë. Përgatitjet për të sulmuar Prishtinën,

20 Në këtë kohë luftërat më të repta u zhvilluan në Keçekollë (14 km në veriperëndim të Prishtinës). (Zbornik, I/14, dok. nr. 116 dhe dok. nr. 199).

21 AIUH, reg. nr. 8/6, k. 181 dhe Zbornik, I/14, dok. nr. 116.

22 Zbornik, XII/4, shtesa 1.

23 Zbornik, XII/4, shtesa 1 dhe Zbornik, I/19, dok. nr. 197.

24 AIUH, reg. nr. 1-18/5, k. 1341; Zbornik, I/19, dok. nr. 202.

25 Zbornik, XII/4, dok. nr. 3.

26 Zbornik, I/14, dok. nr. 15 dhe dok. nr. 33.

në bashkëveprim me forcat bullgare, i bëri Brigada XXV Serbe e Divizionit të 46-të të Korparmatës XIII të UNÇ-së. Më 17. XI. 1944 Brigada XXV Serbe arriti në pozitën Bostan – Tërniçevc – Prekovic – Zebincë.²⁷ Prej aty, më 17. XI. 1944 në periferinë e Prishtinës dërgon njësitet e organizuara vëzhguese. Në të njëjtën kohë njësitet e UNÇJ-së (Brigada e V e Kosovës e Metohisë) në bashkëveprim me njësitet bullgare vepron në jug të Llapit dhe, sikurse njësitet e tjera të UNC-s në juglindje të Prishtinës, luftonin për ripushtimin e Prishtinës dhe të rrethinës. Kështu më 19. XI. 1944, nga veriu në Prishtinë u fut Brigada V NÇ e Kosovës e Metohisë e shoqëruar nga njësitet e Armatës së Dytë Bullgare, kurse nga juglindja po të njëjtën ditë në Prishtinë u futën pjesë të Brigadës XXV Serbe. Rënia e Prishtinës paraqiste edhe fundin e luftimeve frontale dhe ripushtimin e Prishtinës me rrethinë, mirëpo forcat shqiptare dhe të formacioneve- ushtarake e të tjera dolën në mal.²⁸ Natyrisht, për shpartallimin dhe asgjësimin e forcave patriotike mbrojtëse pushtuesit organizuan veprime të mëtejshme luftarake.

Vendosja e të të ashtuquajturit pushtet popullor

Lufta e parë pas ripushtimit kundër shqiptarëve mbrojtës dhe gjermanëve në tërheqje u zhvillua në Dragodan edhe në varrezat e qytetit, gjatë natës së 19/20 nëntorit të vitit 1944. Pasi një batalion i Divizionit të 46-të mundi të dalë prapa këtij grupi ai u shpartallua dhe u arratis.²⁹ Edhe pas kësaj përlëshjeje forcat e UNÇJ-së vijuan me spastrimin e territorit të këtij rrethi. Kështu më 23. XI. 1944, në Prishtinë u dislokua Brigada e 25-të Serbe. në Lipjan ajo e 26-të, kurse në Gjilan Brigada e 27-të Serbe. Përveç këtyre brigadave në rrethin e Prishtinës vepronin pjesa më e madhe e njësiteve të Divizionit të 46-të dhe njësitet e tjera të UNÇJ-së, si edhe njësitet e UNÇ të Shqipërisë, që tashmë kishin arritur në këtë terren.³⁰ Edhe vetë pushtuesit e pranonin se “shumë luftëtarë të njësiteve bullgare, por edhe disa të tjerë të njësiteve të UNÇJ-së, silleshin me popullsinë e këtij rrethi në mënyrë anarkiste dhe hakmarrëse, prandaj, lypsej disiplinë dhe punë e madhe ideopolitike.³¹ Me sjellje hakmarrëse dhe ndjekje të gjëje që frymonte në mënyrë patriotike do të veprohej edhe me rastin e të të ashtuquajturit spastrim të terrenit që u bë nga njësitet e Divizionit të 16-të të UNÇJ-së, veçanërisht Brigada e 25-të, 26-të dhe e 27-të Serbe gjatë muajit dhjetor të vitit 1944.³²

²⁷ Zbornik, XII 4, f. 39.

²⁸ Zbornik, XII 4, f. 39.

²⁹ Zbornik, I 15, dok. nr. 49.

³⁰ Zbornik, I 15, dok. nr. 49, 79 dhe dok. nr. 123

³¹ Zbornik, I 15, dok. nr. 49 dhe dok. nr. 57.

³² Në përlëshjet e Brigadës së 27-të dhe të Brigadës së 26-të me shqiptarët pati 7 të vrarë dhe 17 të plagosur të njësiteve të UNÇJ-së, kurse u vrarë 40 shqiptarë. (AIUH, reg. nr. I 3-17, k. 1340; Zbornik, I/15, dok. nr. 41 dhe dok. nr. 138).

Luftë e pakapërcyeshme dhe e madhe në shpartallimin e patriotëve shqiptarë dhe në vendosjen e të të ashtuquajturit pushtet revolucionar, u bë në kapjen e grupit të Hakif Rimanishtës, më 24. XII. 1944, pastaj veprimet luftarake të njësiteve të divizionit të 46-të të UNÇJ-së në fshatrat malore në lindje dhe në perëndim të kësaj ane (shquheshin luftërat rreth malit Çiçavicë dhe malit Zhegovc) si në fund të muajit dhjetor të këtij viti, ashtu edhe në gjysmën e parë të muajit janar të vitit 1945.³³ Spastrime të tilla pati edhe deri në ripushtimin përfundimtar të Kosovës

³³ AIUH, reg. nr. 3-1 / 1, reg. nr. 43-4, k. 1,411.

Prof. dr. Izber HOTI

SUMMARY

THE DEFENSE OF BORDERS IN GALLAP REGION

The border fightings between Serbians and Albanians implicated also Ottoman (Turkish) forces, French, Austrian-Hungarian, German and Italian. Thus, determination, defense and assault of borders did not depend exclusively on Serbians and Albanians. Unfortunate Albanians usually made alliances with losing side, Ottomans, Austrian-Hungarians and Germans, while South Slavs (Serbians, Montenegrins and Macedonians) sided with victorious Russians and their friends i.e. French. The sacrifices and the lost lives went in veins with no freedom rewarded until much later times when this cause was backed by unwavering and strong allies and friendly states i.e American and English.